



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 1 Tetor 2021

Nr. 457

VENDIM

- Objekt:** Për shqyrtimin administrativ për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj Këshillit të Ministrave dhe Këshillit Bashkiak Durrës
- Kërkues:** Instituti Shqiptar i Shkencave
- Ndaj:** Këshillit të Ministrave dhe Këshillit Bashkiak Durrës
- Baza Ligjore:** Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neni 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata, gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:



Data: 1 Tetor 2021
Nr. 457

Për shqyrtimin administrativ për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj Këshillit të Ministrave dhe Këshillit Bashkiak Durrës

I.Vlerësimi paraprak

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nëpërmjet shkresës së datës 31.05.2021, protokolluar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve më shkresën nr. 5613 prot., datë 02.06.2021, Instituti Shqiptar i Shkencave (Albanian Institute of Science) (*në vijim AIS*), ka paraqitur një denoncim për keqpërdorim të fondeve publike në favor të Partisë Socialiste si nga ana e pushtetit vendor (Bashkia Durrës) si dhe nga ana e pushtetit qendror, përkatësisht Këshilli i Ministrave.

Në këtë denoncim pretendohet se Këshilli i Ministrave dhe Këshilli Bashkiak Durrës ka kryer veprimet e mëposhtme:

- Krijim fondi nga qeveria për Bashkinë Durrës, në data të fushatës zgjedhore pa akt normativ dhe ligj, në mënyrë abuzive me VKM në vlerën 926 449 664 lekë. Në këtë mënyrë në data e fushatës zgjedhore krijohet fond ekstra për pushtetin vendor.
- *Fondi i krijuar kategorizohet si “Transferta tek Individidi” dhe jo si “Shpenzime Kapitale”.*
- *Miratim listash përfituesish pa verifikim statusi “emergjence në strehim” dhe “nevojë për ndihmë”.*
- *Favorizim ndryshim statusit dhe nivelit të përfitimit nga DS1 në DS2 dhe DS3, ndryshime të bëra në data të fushatës zgjedhore.*
- *Ekzekutimi i pagesave në Thesar një javë përpara datës 25 Prill 2021, 16 muaj pas fatkeqësisë dhe 4 muaj pas fillimit të vitit buxhetor.*
- *Abuzim me mosvlerësim të nevojës për ndihmë sipas emergjencës dhe gjendjes vulnerabël.*

Për sa më sipër, kallëzuesi kërkon që, duke marrë parasysh dinamikën kronologjike të vendimmarrjes dhe ekzekutimit në datat e fushatës elektorale, shpërndarjen e buxhetit nga pushteti qendror drejt atij lokal pa akte normative, papërgjegjshmërinë në miratimin e fondit pa u vlerësuar asnjë kusht për përfitimin e ndihmave ekonomike si dhe përdorimi për intimidim i grupeve vulenrabël gjatë fushatës zgjedhore, përbëjnë fakte të mjaftueshme për nisjen e hetimit administrativ.

Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:



- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.

Referuar nenit 7, të ligjit 10279 datë 20.05.2010 “Për kundrvajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi denoncimin vlerëson se duhet të nxjerrë jashtë kompetencës, kërkesat e kallëzuesit në lidhje me pretendimet se miratimi i listave të përfituesve pa verifikim statusin “emergjence në strehim” dhe “nevojë për ndihmë”, favorizim në ndryshimin e statusit dhe nivelit të përfitimit nga DS1 në DS2 dhe DS3 për disa individë, si dhe abuzimi me mosvlerësim të nevojës për ndihmë sipas emergjencës dhe gjendjes vulnerabël.

KQZ nuk është organi kompetent për të vlerësuar dëmin ekonomik, që mund të jetë shkaktuar nga mosvlerësimi i saktë i pretenduar nga denoncuesi.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se të dhënat e tjera të paraqitura nga kallëzuesi përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

II. Rrethanat e faktit



Komisioni Rregullator në KQZ me datë 24.12.2020, ka miratuar vendimin nr. 9 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”. Ky akt normativ ka hyrë në fuqi menjëherë pas miratimit të tij dhe është publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së në datë 26.12.2020. Gjithë të interesuarit mund të disponojnë përmbajtjen e tij nëpërmjet faqes zyrtare të KQZ-së, në rubrikën “Vendime” dhe kategorinë “Vendime të Rregullatorit” duke filluar nga kjo datë.

Referuar denoncimit, kallëzuesi pretendon se aktet e mëposhtme, të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe nga Këshilli Bashkiak Durrës, kanë favorizuar fushatën zgjedhore të Partisë Socialiste.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 6092 prot., datë 16.07.2021, me lëndë “Kërkesë për informacion”, drejtuar Këshillit të Ministrave dhe Këshillit të Bashkisë Durrës, ka kërkuar një informacion të detajuar sqarues, për sa pretendohet nga denoncuesi.

Referuar nenit 7, të vendimit nr. 9 datë 09.04.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator në KQZ, i cili parashikon se: “Afati që ka KQZ-ja për shqyrtimin administrativ të denoncimit është jo më i gjatë se 60 ditë nga paraqitja e tij”.

Edhe pse ka përfunduar afati 60 ditor i shqyrtimit të këtij denoncimi, hetimi administrativ është ende i papërfunduar, pasi pritet përgjigje e Këshillit të Ministrave dhe Këshillit të Bashkisë Durrës, rëndësia e së cilës është thelbësore për shqyrtimin e çështjes.

Komisioneri shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 439, datë 02.08.2021, “Për zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrative të denoncimit për shkelje të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ ndaj Këshillit të Ministrave dhe Këshillit Bashkiak Durrës”, vendosi zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të Institutit Shqiptar të Shkencave, për shkelje të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në KQZ ndaj Këshillit të Ministrave dhe Këshillit të Bashkisë Durrës.

Me shkresën nr. 8535/1 prot., datë 30.07.2021 protokolluar me tonën me nr. 6209 prot., datë 02.08.2021, Bashkia Durrës, nëpërmjet zj. Emeriana Sako, me funksion Zëvendëskryetar, ka kthyer përgjigje kërkesës tonë duke sqaruar se, me qëllim intensifikimin e masave dhe veprimeve për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, si dhe të fatkeqësive të tjera që për shkak të intensitetit, të shkallës dhe të shtrirjes së tyre, kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme të të gjitha institucioneve të mbrojtjes civile, Këshilli i Ministrave, miratoi Aktin Normativ nr. 9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, i cili ka si objekt kryesor të rregullojë funksionimin e organeve përgjegjëse për



rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera si dhe zhvillimin e territoreve të reja, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, programet e procesit të rindërtimit, funksionimin e fondit të rindërtimit dhe procedurat përkatëse.

Në zbatim të këtyre parashikimeve dhe në funksion të zbatimit të programeve të procesit të rindërtimit, Këshilli i Ministrave miratoi një sër aktesh në zbatim të Aktit Normativ, në të cilat u detajuan procedurat që duhet të ndiqen për secilin prej programeve, nga të cilat si më e rëndësishme mund të përmendet vendimi nr. 904, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programme të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar.

Për sa më sipër, në zbatim të akteve të sipërcituar, zj. Sako thekson se, Zyra e Posaçme e Rindërtimit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike, ka vijuar procedurën për dhënien e ndihmës financiare për rikonstruksionin dhe rindërtimin e objekteve të dëmtuara e cila është konkluduar nga Këshilli Bashkiak, Durrës.

Kjo procedurë ka qënë në vijimësi, pa ndërprerje dhe konform fondeve të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, gjatë hetimit administrativ ka administruar:

- Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”;
- Ligjin nr. 97/2019 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”;
- Vendimin nr. 5 datë 06.01.2020 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”;
- Vendimin nr. 189 datë 25.03.2021 i Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të njësisive individuale të banimit dhe njësisive të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Tiranë, Durrës dhe Vorë”;
- Vendimin nr. 205 datë 25.03.2021 i Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale, në bashkitë Durrës dhe Kavajë”;
- Vendimin nr. 43 datë 31.03.2021 i Këshillit Bashkiak Durrës, “Për përdorimin e fondit prej 926 449 664 lekë të përfituar në formën e transfertës së pakushtëzuar nga fondi i rindërtimit i buxhetit të shtetit të vitit 2021”;



- Vendimin nr. 50 datë 14.04.2021 i Këshillit Bashkiak Durrës “Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare, sipas listës së njëmbëdhjetë me subjektet përfitues të programit të grantit për rikonstruksionin e banesave të dëmtuara si pasojë e dëmeve shkaktuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”;
- Vendimin nr. 59 datë 24.04.2021 i Këshillit Bashkiak Durrës “Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare, sipas listës së dymbëdhjetë me subjektet përfitues të programit të grantit për rikonstruksionin e banesave të dëmtuara si pasojë e dëmeve shkaktuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”;
- Shkresën nr. 8535/1 prot., datë 30.07.2021, administruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me nr. 6209 prot., datë 02.08.2021.

III. Analiza ligjore

Këshilli i Ministrave, në datën 16.12.2019, ka miratuar Aktin Normativ nr. 9 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me ligjin nr. 97/2019 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” me objekt rregullimin e funksionimit të organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, programet e procesit të rindërtimit, funksionimin e fondit të rindërtimit dhe procedurat përkatëse.

Pika 2, e vendimit nr. 5 datë 06.01.2020 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, përcakton se transferimi i fondit për grantet e rindërtimit te njësitë e vetëqeverisjes vendore ose tek autoriteti shtetëror përgjegjës bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit të Shtetit për Rindërtimin. Në zbatim të akteve të mësipërme, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 189, datë 25.03.2021 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Tiranë, Durrës dhe Vorë” dhe vendimin nr. 205, datë 25.03.2021 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale, në bashkitë Durrës dhe Kavajë”.



Bashkia Durrës, si njësi vetëqeverisëse vendore, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni nëpërmjet vendimit nr. 43, datë 31.03.2021 ka miratuar përdorimin e fondeve që i janë transferuar nga Këshilli i Ministrave prej fondit të rindërtimit nëpërmjet VKM-ve nr. 189, dhe nr. 205, datë 25.03.2021, në përputhje kjo dhe me nenin 17, pika 1, shkronja a), e Aktit Normativ nr. 9 datë 16.12.2019 i cili parashikonj se *“Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në zbatim të kompetencave të tyre sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile dhe për planifikimin dhe zhvillimin e territorit: a) administrojnë fondet që transferohen nga Këshilli i Ministrave prej fondit të rindërtimit, përfshi dhe kontributet në natyrë, kur caktohen si njësi zbatuese me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas rregullave e procedurave të parashikuara në këtë akt normativ;”*

Po ky akt normativ në nenin 25, pika 1 parashikon se, *“Përfitojnë grante ndërtimi ose rikonstruksioni, sipas projekteve model, familjet e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, shtëpitë e banimit individuale të të cilëve janë klasifikuar si objekt i dëmtuar ose i pabanueshëm”*. Rregulla për projektet model, masa e përfitimit, kushtet, kriteret, procedurat dhe autoritetet përgjegjëse për vlerësimin e kërkesave dhe shpërndarjen e grantit parashikohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Nëpërmjet vendimit nr. 5, datë 06.01.2020 Këshilli i Ministrave, ka miratuar të gjitha kriteret për përfitimin e granteve të ndërtimit ose rikonstruksionit të banesave të dëmtuara nga tërmeti. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, si organe që krijojnë, administrojnë dhe përditësojnë bazën e të dhënave për individët dhe familjet, që kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore, si dhe plotësimin e nevojave të tyre nga programet e procesit të rindërtimit, kanë të dhënat se kush prej këtyre individëve përfiton nga grantet e rindërtimit. Mospublikimi i këtyre të dhënave në vendimet e Këshillit Bashkiak Durrës, jo domosdoshmërisht do të thotë që nuk është kryer vlerësimi i kushteve të përfitimit të këtyre granteve. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nuk ka kompetencë të kontrollojë apo të vlerësojë kushtet mbi të cilat janë shpërndarë këto fonde tek përfituesit.

Për sa më sipër, konstatohet se vendimet e Këshillit të Ministrave kanë dalë në bazë dhe për zbatim të aktit normativ nr. 9 datë 16.12.2019 të Këshillit të Ministrave, miratuar me ligjin nr. 97/2019 *“Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”*.

Referuar nenit 3, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, parashikohet se: *“Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi i akteve ligjore ose nënligjore, ose nxjerrja e tyre me qëllim informimin e publikut në lidhje me vendimmarrjen e institucionit miratues në faqen e tij zyrtare, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes*



ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, faljet e kamatvonesave, të gjobave, të detyrimeve tatimore e doganore vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore ose të epidemisë/pandemisë, apo ka si qëllim zbatimin e një detyrimi ligjor me karakter ndërkombëtar apo zbatimin e një vendim gjyqësor të formës së prerë.”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve konstaton se, sikundër referon Bashkia Durrës, me qëllim intensifikimin e masave dhe veprimeve për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore si dhe të fatkeqësive të tjera që për shkak të intensitetit të shkallës dhe të shtrirjes së tyre, që kërkon ndërhyrjen e menjëhershme të të gjitha institucioneve të mbrojtjes civile, miratoi Aktin Normativ nr. 9 datë 16.12.2019, miratua me ligjin nr. 97/2019, I cili ka si object kryesor të rregullojë funksionimin e organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, programet e procesit të rindërtimit, funksionimin e fondit të rindërtimit dhe procedurat përkatëse.

Këshillit të Ministrave miratoi vendimin nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar. Këshilli i Bashkisë nëpërmjet shkresës nr. 8535/1 prot., datë 30.07.2021, depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve sqaron se, Zyra e Posaçme e Rindërtimit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike ka vijuar procedurën për dhënien e ndihmës financiare për rikonstruksionin dhe rindërtimin e objekteve të dëmtuara e cila është konkluduar nga Këshilli Bashkiak, Durrës. Procedura ka qënë në vijimësi, pa ndërprerje dhe konform fondeve të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Nga këqyrja e faqes elektronike të Qendrës së Botimeve Zyrtare konstatohet se VKM-të, për përdorimin e fondit të rindërtimit për banesat e prekuara nga tërmeti kanë dalë gjatë vitit 2020 dhe kanë vijuar edhe përgjatë vitit 2021.

Nga provat e vëna në dispozicion dhe argumentat e dhëna nga kallëzuesi Komisioneri vlerëson se nuk është në kompetencë të tij të vlerësojë ligjshmërinë e akteve të Këshillit të Ministrave apo vendimeve të këshillit bashkiak Durrës, dalë për zbatimin e tyre.



PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 dhe vendimi nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

V E N D O S:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimit ndaj Këshillit të Ministrave dhe Këshillit Bashkiak Durrës.
2. Të shpall moskompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për shqyrtimin e kërkesave të parashtruara në kallëzim.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Iirjan CELIBASHI

